



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Bali Muharremaj , Kryetar i Komunës së Suharekës Bexhet Kuçi , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi , Ministër i MAPL-së Jeton Qela , Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erbllin Hetemi , Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 05.09.2025 VI-020-337/12
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa , Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj , Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve Komunale	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Suharekës	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës së Suharekës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e kuvendit të komunës në vijim:

Vendim 01-Nr-016-56051 për shfuqizimin e Vendimit 01-Nr-016-31320
I miratuar më datë: 29.08.2025
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 01.09.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.08.2025, ka miratuar Vendimin 01-Nr-016-56051 për shfuqizimin e Vendimit 01-Nr-016-31320.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Suharekës, është bazuar në nenin 12 paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008", e në mbështetje të nenit 28 paragrafi 2 pika (l) lidhur me nenin 29 paragrafi 2 pika (d), të Statutit të Komunës së Suharekës, 01 Nr. 8336 i datës 04.11.2008, e në zbatim të kërkesës së MAPL-së Nr. 020-337/7 të datës 08.07.2025 për rishqyrtimin e Vendimit 01-Nr-016-31320 të datës 30.05.2025 i cili kishte për qëllim dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës konkretisht parcelën kadastrale P-72116046-00545-6.

Neni 2 i Vendimit 01-Nr-016-56051 për shfuqizimin e Vendimit 01-Nr-016-31320, është i pazbatueshëm, duke marr parasysh se kërkesa për rishqyrtim nga MAPL Nr. 020-337/7 të datës 08.07.2025, nuk ka të bëjë me kufizimet ligjore për shpalljen e zgjedhjeve lokale ashtu siç e parasheh neni 10 i Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe neni 33 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Suharekës me datë 29.08.2025, dhe është miratuar më vota unanime.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Bali Muharremaj , gradonačelnik opštine Suva Reka Bexhet Kuçi , predsedavajući Skupštine opštine Suva Reka	
Cc::	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administrarciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi , ministar MALS-a, Jeton Qela , generalni sekretar MALS-a,	
Od:	Erbilin Hetemi , rukovodilac Pravnog odeljenja /MALS	Dana, 05.09.2025
Odgovorni službenici:	Xhevat Tafa , rukovodilac odseka za razmatranje zakonitosti akata opštine i gradonačelnika Vjosa Ahmetaj , viša službenica za razmatranje zakonitosti akata opštine	
1.Službenik/ca za potvrđivanje pravne procene:		
2.Službenik/ca za izradu pravne ocene		
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Suva Reka	
Vrsta odluke:	Odluka Skupštine opštine Suva Reka	

Poštovani/a gradonačelniče/e,
Poštovani/a predsedavajući/a,

U saglasnosti sa članom 9 Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka 01-br-016-56051 o stavljanju van snage Odluke 01-br-016-31320
Usvojena dana, 29.08.2025.god
Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 01.09.2025.god

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština Opštine Suva Reka je na sednici održanoj dana, 29.08.2025.godine, odobrila Odluku 01-br-016-56051 o stavljanju van snage Odluke 01-br-016-31320.

MALS, konstatuje da je odluka doneta od strane Skupštine opštine Suva Reka zasnovana na članu 12, stav 2, slovo (d) Zakona 03/L-040 o lokalnoj samoupravi „Službeni list Republike Kosovo br. 28/2008“, a u skladu sa članom 28 stav 2 tačka (l) u vezi sa članom 29 stav 2 tačka (d), Statuta opštine Suva Reka, 01 br. 8336 od 04.11.2008. godine, i u sprovođenju zahteva MALS-a br. 020-337/7 od 08.07.2025. godine za razmatranje Odluke 01-br.-016-31320, od 30.05.2025.godine, koja je imala za cilj davanje na dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine, tačnije katastarske parcele P-72116046-00545-6.

Član 2 Odluke 01-br-016-56051 o stavljanju van snage Odluke 01-Nr-016-31320 je neprimenljiv, s obzirom na to da se zahtev za razmatranje od strane MALS-a br. 020-337/7 od 08.07.2025.godine, ne odnosi na zakonska ograničenja u vezi sa raspisivanjem lokalnih izbora kako je predviđeno članom 10 Zakona br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine i članom 33 Uredbe (QRK) br. 09/2020 o određivanju postupka za davanje na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine.

Odluka je usvojena na sednici Skupštine opštine Suva Reka dana, 29.08.2025. godine, jednoglasno.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.